



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 7616 prot.

Shkodër, më 10.4. 2025

VENDIM

Nr. 22, datë 08.04.2025

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME
QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR
PËR VITIN 2025”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ; nenit 30 pika 2, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” të ndryshuar; pika 11, 13 e VKM-së nr.522, datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, VKB-në nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore”, i ndryshuar; VKB-në nr.30, datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6 për vitin 2021”, VKB nr.31, datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom”, VKB-në nr.23, datë.10.5.2022 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare, e-mailin e datës 27.02.2025 të Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit”, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2025 si më poshtë:

Qiraja mujore për apartamentin A (sipërfaqe 56.8 m²):
 $3,316 \text{ Lekë} + (3,316 \times 2.2\%) = 3,389 \text{ Lekë/muaj}$

Qiraja mujore për apartamentin B (sipërfaqe 88.9 m²):
 $5,191 \text{ Lekë} + (5,191 \times 2.2\%) = 5,306 \text{ Lekë/muaj}$

Qiraja mujore për apartamentin C (sipërfaqe 96.1 m²):
 $5,611 \text{ Lekë} + (5,611 \times 2.2\%) = 5,734 \text{ Lekë/muaj}$

2. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2025, si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m²
 $1,900 + (1,900 \times 2.2\%) = 1,941 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m²
 $2,500 + (2,500 \times 2.2\%) = 2,555 \text{ Lekë/Muaj}$.

3. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare për vitin 2025 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m²
 $4,279 + (4,279 \times 2.2\%) = 4,373 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m²
 $4,729 + (4,729 \times 2.2\%) = 4,833 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m²
 $7,206 + (7,206 \times 2.2\%) = 7,364 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m²
 $8,107 + (8,107 \times 2.2\%) = 8,285 \text{ Lekë/Muaj}$.

4. Të ardhurat e mbledhura nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin “Qira e ndërtesës” (nga banesat sociale me qira).
5. Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.
6. Niveli i qirasë i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 është i vlefshëm deri me datë 31.01.2026.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me **38** vota

Vota Pro	38
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	08.04.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

